



TË DHËNAT PËR ASETIN

Shitja e Aseteve përmes Likuidimit Nr.71 Njësia e Vendosur në Tender Nr.56 Ratar Tokë Bujqësore Çagllavicë VIII

Emri i NSh.-së	NSH "Ratar" Fi.809/89
Lloji i shitjes	Shitje përmes Likuidimit me ofertë të mbyllur
Dita e Ofertimit	Më 16.04.2025 nga ora 10:00h deri 12:00h në Sallën e Konferencave të "HOTEL GRAND" në Prishtinë
Çmimi minimal	16,200 €/ari
Depozita e Ofertës	€ 45,000
Kategoria potenciale për shfrytëzim	Rezidenciale
<u>Përshkrimi i Aseteve</u>	
Vendndodhja e Aseteve	Zona Kadastrale Çagllavicë, Komuna Prishtinë Të dhënat e hartës ©2024 Google Shikoni këtë pronë në Google Maps Aktmohim: Vendndodhjet e treguara nga PIN-at në Google Maps ofrohen vetëm për qëllime të orientimit dhe referencës së përgjithshme. Këto mund të mos pasqyrojnë saktësisht vendndodhjen, kufijtë ose veçori të tjera të asetëve të përshkruara. Përdoruesit këshillohen të verifikojnë në mënyrë të pavarur të gjitha vendndodhjet për çdo çështje që kërkon saktësi ose informacion me rëndësi ligjore.
Ndërtesat dhe tokat	Ratar Tokë Bujqësore Çagllavicë VIII , përfshinë tokën bujqësore, ngastrën kadastrale 1381-6, me kulturë arë e klasës 1. Ngastra gjendet në zonën kadastrale Çagllavicë dhe ka sipërfaqe të përgjithshme prej 5200m ² (52ari 00m ²). Ngastra 1381-6 gjendet në një zonë atraktive të Prishtinës, po ashtu ngastra nuk ka qasje në rrugë. Ngastra evidentohet në pronësi të P.SH. KBI Kosova Export.
Shfrytëzuesit	Aktualisht ngastra nuk shfrytëzohet as nuk punohet.
Asetet tjera	Nuk ka.
Detyrimet që do të barten	Asnjë nga detyrimet nuk do të barten tek blerësi i ri, por sidoqoftë blerësi potencial duhet të ketë parasysh se mund të jetë i aplikueshëm tatimi për bartjen e pronës.



Foto/fotot
ose informata të tjera
për asetet në shitje



Kjo ortofoto është paraqitur për qëllime orientimi.
Për të dhëna zyrtare referchuni dokumenteve pronësore - juridike.



RATAR
TOKË BUIQËSORE ÇAGLLAVICË V
ZK.ÇAGLLAVICË
KOMUNA PRISHTINË

Legend

 Parcela 13818 ZK Çagllavice



AKP ZR PRISHTINË
QERSHOR 2022

Informatat rreth Njesisë lëndë e shitjes të prezantuar në Te Dhëna nuk janë të garantuara. Investitorët potencial inkurajohen të kontaktojnë Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP) për të kërkuar dokumentet e tenderit. Ata të cilët dëshirojnë të paraqesin ofertë duhet të llogarisin në hulumtimet e tyre. Investitorët potencial këshillohen të bëjnë verifikimin e të dhënave vet para se të paraqesin ndonjë ofertë ose propozim për tender. Këto të Dhëna janë në dispozicion nën kushtet e përgjithshme në informatat paraprake për informacione të publikut të gjerë për kandidatët e privatizimit, e cila mund të nxirret nga faqja e internetit të AKP-së: www.pak-ks.org.



RAPORT MBI VIZITËN E NJËSISË RATAR TOKË BUJQËSORE ÇAGLLAVICË VIII

11.06.2024

Vizita e njësies **RATAR TOKË BUJQËSORE ÇAGLLAVICË VIII** është bërë me 11.06.2024, ku prezent kanë qenë Zyrtari Kadastral Korab Tmava dhe zyrtari i shitjes Granit Spahiu.

Përshkrimi i njësies:

Njësia **RATAR TOKË BUJQËSORE ÇAGLLAVICË VIII** përfshinë tokën bujqësore me sipërfaqe të përgjithshme prej **5200m² (00ha 52ari 00m²)** me parcelat ne zonën kadastrale Çagllavicë komuna Prishtinë:

- **P-71914075-01381-6 sipërfaqe prej 5200m² (00ha 52ari 00m²), me kulturë Arë e klasës 1.**

Parcela ndodhet ne pjesën perëndimore te fshatit Çagllavicë, parcela nuk ka qasje ne rruge (te asfaltuar) zyrtare ne planet kadastrale.

Ne parcele nuk ka ndërtime ilegale.

Parcela punohet pjesërisht nga palët e treta te cilat janë te panjohura për AKP-në!

Raportin e përgatitën:

Korab Tmava

Zyrtar Kadastral, Zyra Rajonale Prishtinë
Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP)

Granit Spahiu

ZOAA, Zyra Rajonale Prishtinë
Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP)

Raporti i vizitës në terren

**Informatat dhe
Dokumentet e Ofertimit**

Divizioni i Marketingut dhe Tenderit Publik

Tel: +383 (0) 38 500 400 lok.1090,2059

www.pak-ks.org

Agjencia Kosovare e Privatizimit

Rr. Dritan Hoxha, nr.55

10000 Prishtinë, Republika e Kosovës